



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë

Tel.+355 4 2226288, Fax.+355 4 22628, www.ama.gov.al

MEM O

Drejtuar: **Z. Alket Kapxhiu**
Specialist IT

Nga: **Znj. Alma Dervishaj**
Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun

Nëpërmjet : **Znj. Eriona Rusmali**
Drejtore në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve;

Lënda: **Mbi publikimin në faqen zyrtare të njoftimit**

Autoriteti i Mediave Audiovizive në mbështetje të nenit 50, pika 3 e ligjit nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" kërkon të rekrutojë një ekspertit të jashtëm për asistencë dhe konsulencë ligjore për hartimin e dokumenteve si me poshtë vijon:

1. Rregullorja e Brendshme e AMA-s;
2. Kodi i Sjelljes i AMA-s;
3. Kodi i Administratës;

TERMAT E REFERENCES

Objektivi

Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të brendshëm të Autoritetit të Mediave Audiovizive

Detyrat

Eksperti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive, për realizimin e detyrave të mëposhtme:

- Me kërkesë të AMA-s dhe në bashkëpunim të ngushtë me stafin, eksperti do të angazhohet në hartimin e akteve si: Rregullore e Brendshme e Institucionit, Kodi i Sjelljes dhe Kodi i Administratës;
- Do të paraqesë shembuj nga vende të ndryshme të rajonit dhe praktika të ngjashme në lidhje me aktet rregullator të brendshëm të institucioneve;
- Do të paraqesë sugjerime dhe në bashkëpunim të ngushtë me stafin e AMA-s do të hartojë dokumentet e sipërcituara;

Autoriteti kontraktues do t'i sigurojë Ekspertit të gjithë informacionin / dokumentet e nevojshme për t'u njohur nga eksperti me qëllim përmbushjen e detyrave të mësipërme.

Periudha e zbatimit të detyrave:

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë deri më datë 31 Dhjetor 2015.

Në rast nevojë, dhe me kërkesën e arsyetuar me shkrim të parashtruar nga eksperti, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë periudhën e zbatimit të kontratës. Çdo zgjatje e kontratës do të jetë subjekt i performancës së mirë nga ana e Ekspertit. Kjo do të gjykohet, në veçanti në drejtim të progresit drejt arritjes së qëllimit të shërbimit.

Kualifikimet dhe aftësitë e ekspertëve:

- Diplomë e integruar ose ekuivalenti i saj në Drejtësi;
- Njohuri të thelluara mbi legjislacionin e fushës së medias;
- Përvojë minimumi të paktën 6 (gjashtë) vjeçare në fushën e hartimit të akteve Nënligjore;
- Eksperienca e mëparshme në kërkime shkencore akademike dhe publikimi ose hartimi i politikave do të jetë avantazh;
- Përvojë dhe pjesëmarrje në shërbime të tjera të ngjashme;
- Aftësi organizuese; planifikim dhe përmbushje e afateve;
- Shkrim dhe lexim i rrjedhshëm i gjuhës angleze.

Produktet dhe materialet

Eksperti do të paraqesë në gjuhën shqipe të gjitha propozimet, rekomandimet, Dokumentet e hartuara në AMA.

Raportimi

Eksperti do të mbajë komunikim të ngushtë me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Aktet nënligjore për t'u hartuar/miratuar deri në fund të vitit 2015, për të cilat kërkohet asistencë dhe konsulencë juridike nga ekspert i jashtëm janë si më poshtë:

1. Rregullorja e Brendshme e AMA-s;
2. Kodi i Sjelljes i AMA-s;
3. Kodi i Administratës;

APLIKIMET MBYLLEN ME DATE 30 SHTATOR 2015